



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 06.05.2019, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë së Trajtimit të Pronave për veprimtarinë e ushtruar gjatë vitit 2018
2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në strukturën dhe organikën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”

**Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Korab Lita, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Elena Xhina, Edlira Bode dhe Xhemal Qefalia

**Mungojnë:**

Damian Gjikhuri, Alket Hyseni, Alban Zeneli, Elda Hoti dhe Tom Doshi

**Të ftuar :**

Jonida Baci - Drejtoreshë e Përgjithshme e Agjencisë së Trajtimit të Pronave

Sokol Demaliaj - Drejtor i Kompensimit në Agjencinë e Trajtimit të Pronave

Edmond Lala - Drejtor Juridik në Agjencinë e Trajtimit të Pronave

Artur Metani - Avokat i Përgjithshëm në Avokaturën e Shtetit

Eva Dyrmishi - Avokate e Shtetit

Abaz Deda - Avokat i Shtetit

Hajdar Noka - Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Institucioneve të tjera të Varësisë në Ministrinë e Drejtësisë.

## **HAPET MBLEDHJA**

**Ulsi Manja** – Përshëndetje të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e komisionit për ditën e sotme duke u uruar një ditë dhe javë të mbarë kolegëve dhe gjithë të pranishmëve!

Në rendi i ditës për sot ka dy çështje: çështja e parë është shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë së Trajtimit të Pronave për veprimtarinë e ushtruar gjatë vitit 2018. Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relator është kolegu Jurgys Çyrbja.

Si pikë e dytë e rendit të ditës është shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në strukturën dhe organikën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Edhe për këtë çështje komisioni ynë është komision përgjegjës. Relator është kolegu Bashkim Fino.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, me raportimin e Agjencisë së Trajtimit të Pronave për veprimtarinë e ushtruar gjatë vitit 2018. Kanë konfirmuar pjesëmarrjen dhe janë sot prezentë nga Agjencia e Trajtimit të Pronave: zonja Jonida Baci, Drejtoreshë e Përgjithshme, zoti Sokol Demaliaj, Drejtor i Kompensimit dhe zotin Edmond Lala, Drejtor Juridik.

Nga Avokatura e Shtetit kemi të ftuar: zotin Artur Metani, avokat i përgjithshëm i Shtetit, zonjën Eva Dyrmishi, avokate e Shtetit dhe zotin Abaz Deda, avokat i Shtetit.

Nga Ministria e Drejtësisë është konfirmuar pjesëmarrja e zotit Hajdar Noka, përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Institucioneve të tjera të Varësisë.

Mirë se keni ardhur në komision!

Komisioni i Ligjeve është në vazhden e raportimeve të institucioneve të pavarura, të krijuara me ligj, që janë në sferën e përgjegjësisë së komisionit. Natyrisht, jemi në funksionin tonë të ushtrimit të kontrollit parlamentar. Sot radhën e ka Agjencia e Trajtimit të Pronave.

Dihet problematika e pronave në Shqipëri, ju jeni një nga agjencitë që prodhoni tituj pronësie dhe është me shumë interes për ne anëtarët e komisionit, por edhe për opinionin publik, të dimë cili ka qenë aktiviteti juaj për vitin 2018.

Kolegët e komisionit e kanë përpara raportin e detajuar që keni paraqitur në Komisionin e Ligjeve, por edhe raportet periodike që keni sjellë janë bërë të njohura për kolegët deputetë, ndaj

do t'ju lutesha të bëni një përmbledhje të gjetjeve të këtij raporti, që lidhen drejtpërsëdrejti me punën tuaj.

Fjala për ju.

**Jonida Baci** - I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë, anëtarë të Komisionit,

Në cilësinë e Drejtoreshës së Përgjithshme të ATP-së ndodhem këtu për të prezantuar punën e Agjencisë së Trajtimit të Pronës për vitin 2018.

Ky raport reflekton punën e ATP-së përgjatë vitit 2018 duke dhënë informacionin për objektivat e arritura gjatë këtij viti, si dhe për periudhën nga 1 janar 2019 deri më 23.02.2019, datë kjo e cila përkon me mbarimin e afatit 3-vjeçar të ligjit, për sa i përket njohjes të së drejtës të pronësisë dhe vlerësimit financiar të vendimeve përfundimtare.

Agjencia e Trajtimit të Pronave gjatë vitit 2018 e ka fokusuar punën e saj në përmbushjen e dy prioriteteve kryesore: Ligji nr. 133/2015 ka hyrë në fuqi në datën 23.02.2016 duke përcaktuar një afat 3-vjeçar si për vlerësimin financiar të vendimeve përfundimtare, ashtu dhe për shqyrtimin e kërkesave për njohje pronësie. Ndërsa për periudhën 10-vjeçare, nga hyrja në fuqi e ligjit, ATP është ngarkuar që të kryejë ekzekutimin e vendimeve përfundimtare, që janë vlerësuar financiarisht sipas mënyrës të përcaktuar në VKM nr. 223/2016, të ndryshuar. Kompensimi i këtyre vendimeve do të bëhet sipas prioriteteve të përcaktuara, në kompensim fizik në pronën e ish-pronarit, kompensim fizik nga fondi i tokës dhe kompensim financiar.

Stafi i Agjencisë së Trajtimit të Pronës është angazhuar dhe ka arritur të përfundojë brenda afatit një nga proceset më të rëndësishme, që është vlerësimi financiar i vendimeve përfundimtare që kanë njohur të drejtën e kompensimit me qëllim nxjerrjen e një fature financiare.

Sa i takon procesit të shqyrtimit të kërkesave për njohje pronësie, evidentojmë faktin se ky proces pësoi një ndalim pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese në janar të vitit 2017, i cili konstatoi si të papajtueshme me Kushtetutën disa dispozita të ligjit që kishin të bënin pikërisht me këtë proces. Pas reflektimit të qëndrimeve të mbajtura nga ana e Gjykatës Kushtetuese, u materializuan aktet nënligjore të miratuara në dhjetor të vitit 2017, konkretisht VKM-të nr. 765 dhe 766, të cilat hynë në fuqi në janar të 2018.

Opinione pozitive për ligjin nr.133/2015 nuk munguan si nga Komisioni i Venecias dhe së fundi nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, i cili miratoi dhe një rezolutë në shtator të vitit 2018, ku vlerësoi mekanizmin e ngritur nga qeveria shqiptare me anë të ligjit nr.133/2015

“Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit”, si një mekanizëm efektiv të brendshëm, i cili adreson shkeljet e gjetura nga gjykata në vendimin pilot Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë. Këshilli i Europës e konsideron ligjin si një mekanizëm efektiv dhe gjithë strukturat e ngritura për zbatimin e tij brenda afateve të caktuara si efikase.

Pas opinioneve pozitive të marra nga institucionet ndërkombëtare, ATP-ja ka vijuar punën për shqyrtimin e kërkesave për njohje pronësie duke shfrytëzuar maksimalisht kohën e mbetur, si dhe të gjitha burimet njerëzore në dispozicion, në mënyrë që të trajtonte kërkesat e sa më shumë subjekteve pretendues.

Po ju parashtrijmë punën e ATP-së për vitin 2018, në dy proceset kryesore:

Në procesin e kompensimit ATP-ja përmban:

- Vlerësimin financiar të vendimeve përfundimtare dhe ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të vlerësuar.
- Shpërndarjen e fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale (ALUIZNI).

Vlerësimi financiar i vendimeve përfundimtare

Përgjatë vitit 2018, ATP-ja ka vijuar me vlerësimet financiare të vendimeve përfundimtare, të cilat kanë njohur të drejtën e pronës për kompensim, duke përfunduar vlerësimin financiar të 9458 vendimeve të pavlerësuar më parë. Nga ky vlerësim rezultuan të dhënat si më poshtë:

- ▶ 8642 vendime u vlerësuan financiarisht me një vlerë prej 34 156 228 643 (tridhjetë e katër miliardë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë milionë e dyqind e njëzet e tetë mijë e gjashtëqind e dyzet e tre) lekëve.
- ▶ 632 vendime konsiderohen të kompensuara referuar nenit 7 të ligjit nr. 133/ 2015.
- ▶ 184 vendime u njohën me të drejtën e parablerjes.

Përgjatë 3 vjetëve deri në datën 23.02.2019, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vlerësuar gjithsej 25.968 vendime përfundimtare për kompensim të viteve 1993 – 2013, vlerësim prej të cilit rezultuan të dhënat si më poshtë:

- ▶ 20710 vendime u vlerësuan financiarisht me një vlerë prej 100 655 738 106 (njëqind miliardë e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë milionë e shtatëqind e tridhjetë e tetë mijë e njëqind e gjashtë) lekëve, vlerë e cila mund të ndryshojë pasi ATP-ja është në pritje të përfundimit të ankimeve gjyqësore nga subjektet në bazë të afateve ligjore.

- ▶ 3721 vendime konsiderohen të kompensuara referuar nenit 7 të ligjit nr.133/2015.
- ▶ 719 vendime u njohën me të drejtën e parablerjes.

Gjatë procesit të rivlerësimit të kësaj kategorie vendimesh nga grupet e grupet e punës është konstatuar se 818 vendime janë propozuar të fshihen nga regjistri, pasi kanë kaluar të parregullta formalisht. Për shembull, një rast i tillë është vendimi dhe harta e ish-KKP-ve, e cila ndodhet e administruar në cilësinë e fotokopjes ose të kopjes së noterizuar apo vendime që kanë figuruar të duplikuara në regjistër.

Të nderuar,

Në lidhje me kompensimin financiar të vendimeve përfundimtare, në vitin 2018 buxheti i shtetit ka akorduar një fond prej 2,5 miliardë lekë nga 3,69 miliardë lekë që parashikoheshin në ligj. Gjithsesi, këtij fondi i është shtuar fondi i mbartur i vitit 2017 në vlerën 0,3 miliard lekë ku në total për vitin Agjencia e Trajtimit të Pronave ka pasur një fond financiar prej 2,8 miliardë lekë.

Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2018, ATP-ja ka regjistruar pranë sporteleve 429 aplikime për kompensim financiar dhe fizik dhe janë ekzekutuar 18 vendime, duke shpërndarë nga fondi financiar një vlerë prej 35 521 553 lekë, nga fondi i tokës një sipërfaqe prej 568 909 metra katrorë me një vlerë financiare prej 116 637 991 lekë. Për kompensimin financiar me kërkesë të veçantë Agjencia e Trajtimit të Pronave, siç ju e dini, kryen edhe një procedurë tjetër atë të trajtimit me kërkesë të veçantë që do të thotë kompensim progresiv për 20%, 30% dhe 40%, referuar nenit 17 të ligjit nr. 133/2015. Kjo procedurë është lehtësuese për subjektet, të cilat kanë një vendim kompensimi përfundimtar dhe mund të aplikojnë jashtë radhës kronologjike, duke përfutur trajtim të menjëhershëm.

Gjatë periudhës së raportimit për ekzekutimin e vendimeve me kërkesë të veçantë rezulton se janë pranuar 129 aplikime, janë ekzekutuar 86 aplikime, dosje, të cilat kanë përfutur këstin e parë dhe fondi që do të lëvrohet për këto 86 aplikime në total kap vlerën 1 507 504 425 lekë. Gjithashtu, është lëvruar kësti i dytë për 10 aplikime, kësti i tretë për 2 aplikime, si dhe është mbyllur procedimi administrativ për 4 aplikime.

Ju bëj me dije se nga kjo formë kompensimi e parashikuar në ligjin nr. 133, të vitit 2015 vetëm për aplikimet e mësipërme buxhetit të shtetit i kursehet një shumë prej 3 010 751 266 lekë. Gjatë vitit 2018 është shpërndarë një fond kompensimi financiar prej 1 543 025 978 lekë në total. Nga hyrja në fuqi e ligjit të ri Agjencia e Trajtimit të Pronave ka shpërndarë për kompensim financiar një vlerë prej 5 564 685 714 lekë, si dhe ka shpërndarë nga fondi fizik i pronave një

sipërfaqe prej 380,3 hektarë me një vlerë financiare prej 779 860 100 lekë. Gjatë vitit 2018 është shpërndarë një sipërfaqe prej 568 909 metra katrorë me një vlerë 116 637 991 lekë. Ju bëj me dije se është realizuar bllokimi dhe regjistri i pasurive tokë bujqësore pranë ZVRPP-ve në qarqet Korçë, Elbasan, Berat dhe Gjirokastrë në favor të ATP-së. Ky proces është realizuar me angazhimin e burimeve të ATP-së pas një marrëveshjeje mirëkuptimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Të nderuar,

Sfidat që ka ATP-ja për vitin 2019 për procesin e kompensimit janë si më poshtë:

1. do të vijohet me ekzekutimin e vendimeve për ato subjekte, të cilat aplikojnë konformë akteve nënligjore në fuqi;
2. do të pasurohet fondi i tokës, i cili do të kalojë në dispozicion të ATP-së për kompensimin e subjekteve të shpronësuara;
3. do të vijojë ekzekutimi i vendimeve të pronarëve të pasurive të paluajtshme pronë private që preken nga ndërtimet informale. Në këtë proces ATP-ja shikon mundësinë e vijimit të likuidimit të vlerës së plotë të tyre me 100% nga 70% që është likuiduar deri më sot;
4. do të mundësohet vlerësimi i akteve nënligjore, të cilat do ta përmirësojnë më tej procesin e kompensimit.

Sa i përket procesit të kompensimit për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale, ju informoj se pranë ATP-së kanë aplikuar 1745 qytetarë për periudhën janar-dhjetor 2018. ATP-ja ka trajtuar me vendim 1727 kërkesa nga 1745 aplikime në vlerën 2 147 038 000 lekë, dokumentacioni i të cilëve ka rezultuar i plotë dhe në përputhje me VKM nr. 383 të vitit 2010, i ndryshuar me VKM-të përkatëse ku është miratuar ky shpërblim.

Ju bëj me dije se vetëm për periudhën që mbulon ky raportim janë miratuar nga Këshilli i Ministrave gjashtë VKM në lidhje me këtë proces. Dua të theksoj se në bazë të përlllogaritjeve të fondeve në dispozicion për realizimin e kompensimit të pronarëve, të cilat përcaktohen në bazë të ligjit vjetor për buxhetin e shtetit, subjektet përfituese janë trajtuar vetëm me 70% të vlerës totale të shpërblimit të miratuar në VKM.

Të nderuar,

Një pikë e dytë e raportit është ajo e trajtimit të kërkesave për njohje pronësie dhe kompensimi. Agjencisë i është caktuar një afat 3-vjeçar nga hyrja në fuqi e ligjit për trajtimin e kërkesave për njohjen e pronësisë, të patrajuara prej vitit 1993 deri në vitin 2016. Procesi i

shqyrtimit të ligjit pranë Gjykatës Kushtetuese ka sjellë pamundësinë e ATP-së për të vepruar në zbatim të ligjit për një periudhë 18-mujore, kohë që nevojitet për shqyrtimin e ligjit nga kjo gjykatë dhe plotësimin e tij me aktet nënligjore të nevojshme në zbatim të rekomandimeve të gjykatës. Ky proces përfundoi në dhjetor të vitit 2017.

Gjatë vitit 2018, ATP-ja angazhoi të gjitha kapacitetet e saj në dispozicion për shqyrtimin e kërkesave për njohje pronësie. Në ATP janë të administruara gjithsej për 12 qarqet e Republikës së Shqipërisë 16 462 dosje dhe praktika. Nga këto 10 000 dosje janë mbartur nga ligji nr. 9235 i vitit 2014, si dhe rreth 6000 dosje janë krijuar me ligjin nr. 133 të vitit 2015.

Për vitin 2018 deri në shkurt të vitit 2019 janë përmbyllur me vendim rreth 6000 dosje/kërkesa për të gjitha qarqet e Republikës së Shqipërisë. Në total nga hyrja në fuqi e ligjit janë trajtuar me vendim 9512 kërkesa dhe kanë mbetur pa trajtuar me vendim rreth 6950 kërkesa, për të cilat subjektet aplikues mund t'i drejtohen Gjykatës së Shkallës së Parë, proces, i cili është parashikuar në nenin 34, të ligjit nr.133/2015.

Problematikat e hasura gjatë procesit të shqyrtimit, të trajtimit të kërkesave për njohje pronësie kanë qenë të ndryshme, si nga qytetarët që nuk plotësojnë dokumentacionin e kërkuar sipas akteve nënligjore në fuqi, po ashtu edhe nga konfirmimet nga Institucionet e treta ku ATP-ja ka detyrimin ligjor për të bërë konfirmimet përkatëse. Në shumë raste institucionet e treta e kishin të pamundur të konfirmonin, pasi dokumentacionet ishin djegur, zhdukur apo vjedhur në zyrat e Kadastrës, Arkivave dhe ZVRPP-ve gjatë viteve të tranzicionit.

Tjetër problematikë e hasur është fakti se procesi i azhurnimit për regjistrimin e pronës pranë ZVRPP-ve është drejt përfundimit, duke sjellë vonesa ose pamundësi të justifikueshme në dhënien e informacionit për statusin juridik të pronës së pretenduar, si dhe mosplotësimin e dokumentacionit hartografik.

Sfida e ATP-së në lidhje me përmbylljen e këtij procesi është:

- dorëzimi i dosjeve, të cilat janë depozituar nga subjektet për procesin e njohjes, duke u dhënë dokumentet origjinale dhe në ATP të mbahen fotokopjet;
- dixhitalizimi i dokumentacionit dhe përmirësimi sistemit *Web-Gis*;
- asistenca ndaj subjekteve dhe institucioneve që do të përfshihen tashmë në vijimin e procesit në gjykatat e vendit, siç është rasti i Avokaturës së Shtetit.

Të nderuar,

Për sa më sipër, ju informova vetëm për dy proceset kryesore të veprimtarisë së ATP-së, të cilat janë më kryesoret dhe për arsyen që ka dalë edhe vetë ligji nr. 133/2015, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Për këto procese ATP relaton edhe pranë Komitetit të Ministrave në Strasburg.

ATP-ja ka një veprimtari më të gjerë, e cila është mbështetëse e plotësimit të veprimtarive të mësipërme dhe një nga këto është edhe përfaqësimi ligjor pranë gjykatave, si dhe mbrojtja e interesave të ATP-së në tre shkallët e gjyqësorit dhe në Gjykatën Administrative për vendimet e dhëna ndër vite, si dhe për vendimet e dhëna në zbatim të ligjit nr. 133 të vitit 2015.

Një informacion i rëndësishëm për t'u përmendur për mirëzbatimin e ligjit nr. 133/2015, si dhe të akteve të tjera të dala në zbatim të tij nga ATP-ja, është fakti se pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë janë depozituar ankimime me objekt gjykimi: "Kundërshtimin e vlerësimit financiar të vendimeve përfundimtare në mbështetje të nenit 19 të ligjit".

Gjithsej janë depozituar 371 padi, nga të cilat janë pranuar nga Gjykata Administrative e Apelit vetëm 32 kërkesa. Kjo tregon që puna e kryer në lidhje vlerësimet financiare ka qenë në interpretim të saktë të ligjit, duke përmendur faktin që janë vlerësuar gjithsej 25 968 vendime, që kanë njohur të drejtën e kompensimit.

Gjithashtu, po në zbatim të ligjit nr. 133/2015 në lidhje me kërkesat që kanë qenë depozituar pranë ATP-së, të cilat janë trajtuar gjatë këtij 3 –vjeçari, nga 16 462 dosje të tilla u trajtuan me vendim 9512 dhe në zbatim të nenit 29 të ligjit nr. 133/2015 janë depozituar pranë gjykatave të apeleve civile vetëm 423 kërkesë padi dhe nga këto vetëm 38 vendime janë fituar nga pala paditëse. Pra, dhe këtu kuptohet qartë një bilanc pozitiv dhe një interpretim i saktë i ligjit.

Asnjëherë më parë ATP-ja nuk ka parë një bilanc aq pozitiv sa në çështjet gjyqësore të dala nga dispozitat e ligjit nr. 133/2015.

Tjetër proces që kryen ATP-ja, edhe pse nuk parashikohet në ligjin organik nr. 133/2015 është ai i trajtimit të kërkesave për tjetërsim të sipërfaqeve shtetërore, sipas VKM-së nr. 578 datë 29.08.2012 "Për përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim", të ndryshuar". ATP në lidhje me këtë proces, për vitin 2017 ka trajtuar me vendimmarrje 510 kërkesa të subjekteve të regjistruara gjatë viteve, gjithashtu gjatë kësaj periudhe, kanë aplikuar pranë institucionit 171 subjekte nga të gjitha qarqet.

Si përfundim po ju relatojmë edhe informacion përrezolutën e lënë nga viti 2018 nga deputeti Alket Hyseni, i cili kërkoj informacion të detajuar për veprimtarinë e ATP-së në lidhje



me ndjekjen e kallëzimeve penale të bëra nga ATP-ja, verifikimin e ecurisë së çështjeve të ngritura task forca pranë Kryeministrit për verifikimin e ligjshmërisë dhe mënyrës së tjetërsimit të pronave të paluajtshme shtetërore.

ATP-ja në vijim të detyrave të lëna ngriti një grup pune me urdhër nr. 121, datë 19.04.2018 për verifikimin e ecurisë dhe marrjen e informacionit për kallëzimet penale të bëra nga ish-Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, sot Agjencia e Trajtimit të Pronave në kuadër të informacioneve të dhëna nga task forca e ngritur me urdhër të Kryeministrit nr.70, datë 13.02.2014, dhe nga Marrëveshja e Bashkëpunimit me urdhër nr.2981 prot., datë 29.08.2015.

Nga verifikimi që është bërë për 49 rastet, pranë prokurorive të rretheve gjyqësore, gjykatave të rretheve gjyqësore dhe Avokaturës së Shtetit, rezulton se deri në datën 30.03.2019 është depozituar ky informacion: për 1 (një) kallëzim penal është vendosur nga gjykata lënien ne fuqi e vendimit të prokurorisë për pushimin e çështjes penale; për 1 (një) kallëzim penal është vendosur nga prokuroria pushimi i pjesshëm të procedimit penal për disa shtetas i akuzuar dhe deklarimin fajtor të një shtetasi për veprën penale të falsifikimit të dokumentacionit; për 3 (tri) kallëzime penale është vendosur nga gjykata deklarimi fajtor për veprën penale “Pastrim i produkteve të veprës penale”; për 1 (një) kallëzim penal është dërguar gjykatës për gjykim të çështjes penale në themel; për 2 (dy) kallëzime penale gjykata ka vendosur deklarim i pafajshëm; 5 (pesë) kallëzime penale janë akoma nën hetim nga prokuroria; për 33 (tridhjetë e tre), kallëzime penale, prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka vendosur pushimin e çështjes penale për shkak të parashkrimit të veprës penale; për 3 (tri), kallëzime penale është vendosur mosfillimi i procedimit penal, për shkak të mungesës së veprës penale.

Të nderuar, kjo ishte shkurtimisht veprimtaria dhe detyrat kryesore të përmbushura nga ATP-ja gjatë vitit 2018.

Për çdo gjë të paqartë të cituar më sipër apo për pyetje, të cilat kanë të bëjnë me objektivat dhe detyrat e ATP-së, jam e gatshme t’ju përgjigjem bashkë me stafin tim.

Faleminderit për vëmendjen tuaj.

**Ulsi Manja**- Faleminderit, zonja Baci.

Fjalën e ka deputeti Qyrbja.

**Jurgis Çyrbja** – Unë mendoj se zonja Baçi ishte e qartë në raportimin për Agjencinë e Pronave.

Unë do të ndalem në disa momente që janë çështje për diskutim edhe në interes të publikut.

Zonja Baçi, në raportimin në komisionit tonë për vlerësimin e performancës së ATP-së gjatë vitit 2017 është rekomanduar iniciimi i propozimeve për ndryshimin e akteve nënligjore në fuqi me qëllim adresimin e problematikave të evidentuara nga kjo Agjenci gjatë procesit të njohjes dhe kompensimit të pronave. Sa më sipër, a është ndërmarrë iniciativa për propozimin e ndryshimeve të nevojshme në këto akte nënligjore të miratuara në ligjin nr. 133/2015 për të adresuar këto problematika! Unë doja të dija se në çfarë faze ndodhen këto iniciativa dhe cilave çështje synohet t'iu jepet zgjidhje nëpërmjet këtyre propozimeve?

Në raportin e Agjencisë për vitin 2018 paraqitet informacion vetëm në lidhje me numrin e çështjeve të iniciuara në Gjykatën Administrative, gjykatat e rretheve dhe numrin e çështjeve të ankimuara. Cili është efekti financiar që kanë sjellë për shtetin çështjet e përfunduara me vendim gjyqësor të formës së prerë? Bazuar në nenin 29 të ligjit nr. 133/2015 kundër vendimit të ATP-së për njohjen e së drejtës, kanë të drejtë të paraqesin ankim jo vetëm palët e interesuara, por edhe Avokatura e Shtetit. Sa ankime kundër vendimeve të Agjencisë janë paraqitur nga Avokatura e Shtetit dhe cila ka qenë vendimmarrja përfundimtare e gjykatave?

Një nga rekomandimet e lëna në raportin e vlerësimit të veprimtarisë së ATP-së gjatë vitit 2017 ka qenë nxitja e vijimit të ushtrimit të veprimtarisë së Komisionit Ndërinstitucional për Identifikimin e Pronës Shtetërore, që mund të kalojë dhe të bëhet pjesë e tokës për kompensimin e pronave. Nisur nga kompetencat që VKM-ja nr.901/2016 ka paraqitur për këtë komision, cila ka qenë ecuria e punës së kësaj strukture për vitin 2018 dhe në ç'fazë ndodhet procesi i identifikimit të pronave shtetërore që do të kalojë në fondin e tokës në dispozicion për kompensim?

**Ulsi Manja-** Po, zonja Baci, jepni përgjigjet e pyetjeve të zotit Çyrbja, pastaj kalojmë te pyetjet e kolegëve të tjerë.

**Jonida Baci** – Në lidhje me ndryshimet për procesin e shqyrtimit, këto ndryshime kanë ndodhur në dhjetor të vitit 2017, hynë në fuqi në janar të vitit 2018 dhe vetëm pas këtyre ndryshimeve ATP-ja filloi procesin e trajtimit të kërkesave për njohje pronësie. Nuk ka pasur asnjë ndryshim tjetër ligjor gjatë këtij viti. I gjithë unifikimi i procedurave u bë përmes ndryshimit të VKM-së nr. 222, sot nr. 766.

Në lidhje me proceset gjyqësore, unë sapo relatova vetëm 32 raste nga 457 raste janë në proces ankimimi, kështu që praktikisht ende nuk kemi asnjë vendim të formës së prerë, prandaj ne e paraqesim si sukses faktin që nga 457 padi, vetëm 32 janë fituar, por për të cilat ende nuk ka një vendim të formës së prerë.

Sa i përket punës nga Komiteti Ndërinstitucional për Pasurimin e Tokës duhet të them se gjatë vitit 2018 i vetmi proces që është kryer është bllokimi pranë ZRPP-ve nga ATP-ja në bashkëpunim edhe me ALUIZNI-n, ku bëmë një lloj hartëzimi të çështjes në favor të ATP-së. 23 mijë hektarë sot, të cilat janë në dispozicion të këtij institucioni janë të bllokuara. Në fakt, edhe me gjithë ristrukturimin që po ndodh duhet të kemi bashkëpunim me Agjencinë e Kadastrës, e cila po bën evidentimin e këtyre pronave. Ne si sekretariat kemi bërë disa propozime, të cilat mund të vijohen gjatë këtij viti. Për hir të së vërtetës ky vit ka qenë kryesisht i fokusuar në vlerësimet financiare të vendimeve dhe trajtimin e shërbimit, gjithashtu, dhe kemi pasur mjaftueshëm fond toke për të vijuar edhe me kompensimin.

**Ulsi Manja**– Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Qefalia.

**Xhemal Qefalia** - Faleminderit!

Çështja e pronave dhe ish- pronarëve, ose pronarëve realë ka një sensibilitet shumë të madh, sidomos në qarkun e Tiranës, ku unë jam edhe deputet i zonës, por ndoshta në rrethet e tjera nuk është ky problem. Në këtë kuadër, unë dua t'ju drejtoj disa pyetje, të cilat burojnë nga kontaktet që kemi me qytetarët dhe me ish-pronarët, pasi vazhdimisht nuk është se ka pasur një dakordësi ndërmjet tyre dhe ligjeve që ne kemi miratuar. Sipas raportit, për të cilin ju u shprehët se keni operuar që nga viti 1993 deri të vitin 2013, a keni një *database*, e cila përcakton se sa prej tyre janë likuiduar plotësisht financiarisht ose janë kompensuar gjatë kësaj periudhe?

Së dyti, ka pasur shumë vërejtje për mënyrën e trajtimit dhe shpërndarjes së trajtimit financiar. Sa transparente është bërë kjo gjë?

Së treti, ju referuat këtu nenin 34 të ligjit nr. 133/2015, ku shpreheni se shumë nga këto procedura nuk janë të sakta dhe për këtë i keni mbushur gjykatat duke i adresuar ish-pronarët për të shkuar edhe një herë në gjykatë. A mundeni që, nga statistikat që ka nxjerrë drejtoria juaj, të përcaktoni se cilat janë kërkesat që nuk përmbushin këta ish-pronarë?

Faleminderit!

**Ulsi Manja** - Faleminderit, zoti Qefalia!

Po, mund të vazhdoni.

**Jonida Baci** – Në lidhje me procesin e kompensimit, siç edhe e relatova, janë 512 raste në total të kompensuara. Këtu po flas nga fillimi i hyrjes në fuqi të ligjit nr. 133/2015. Aktualisht janë edhe 1454 aplikime nga 18 mijë raste që janë gjithsej. Ne duhet të kemi parasysh se kërkesat vinin pranë ATP-së pas çdo vlerësimi të bërë ndër vite. Siç e relatova, ATP-ja e fokusoi punën në vitin e fundit, duke qenë se kishim një afat ligjor për të përmbyllur vlerësimin dhe për të nxjerrë një faturë financiare totale për buxhetin e shtetit.

Gjithashtu, dua të shtoj se, për hir të ndryshimeve ligjore, pati një lloj tërheqjeje nga subjektet përgjatë vitit 2018. Nga rezymeja që bëmë për vitin 2018 na rezultoi se ka pasur vetëm 400 aplikime deri në dhjetor, ndërkohë që pjesa më e madhe e aplikimeve kanë qenë në vitet 2016-2017. Ne do të vazhdojmë punën gjatë vitit 2019, sidomos për këtë periudhë dhe në vijim ATP-ja do të punojë praktikisht vetëm për ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të vlerësuara.

Në lidhje me parregullsinë apo paqartësinë e subjekteve për transparencën, nuk di çfarë të them, sepse nuk ka një rend kronologjik ligjor vjetor që ne e ndjekim. Mbase ne duhet të jemi më konkretë dhe ta diskutojmë, por çdo gjë është e publikuar sipas të gjitha dispozitave ligjore në fuqi. Në fakt, ka një problematikë që ky ligj kërkon dhe të gjitha subjektet duhet ta bëjnë. Kjo është edhe arsyeja që aplikimet janë kaq të ulëta. Për mungesë dakordësie, për mungesë problematikash e të tjera, qoftë edhe dokumentacioni, kjo shpjegon deri më sot numrin e ulët të aplikimeve në qoftë se e krahasojmë me numrin e vendimeve të vlerësuara.

Për sa i përket procesit të trajtimit, se sa kemi çuar dhe sa mbeten pa u trajtuar në gjykatë, janë 6950 raste. Duhet të keni parasysh se ATP-ja gjatë vitit 2018 ka numrin më të lartë të vendimeve të themelit të dhëna ndër vite. Nëse ne i referohemi vitit 2013, mund të them se ATP-ja ka dhënë 808 vendime themeli dhe sot që flasim janë 6 mijë kërkesa, duke pasur parasysh se kishim vetëm 1 vit në dispozicion, jo 3 vjet, siç ishte parashikuar në fillim. Ndaj, ky numër është goxha i konsiderueshëm për punën që ka bërë stafi i ATP-së. Sigurisht, kjo është edhe arsyeja që është parashikuar në ligj në nenin 34, që çdo vendim ose çdo kërkesë e patrajtuar subjektit nuk i humb e drejta për të shkuar në gjykatë. Ajo çfarë ne bëjmë me këto subjekte është se i thërrasim, i këshillojmë, u japim dokumentet origjinale dhe më pas procesin fillon nga aty. Sigurisht, ne mund të flasim edhe për raste konkrete dhe për këtë jemi të hapur.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** - Faleminderit, zonja Baci!

Po, zoti Qefalia.

**Xhemal Qefalia** – Në mënyrë që të jem më konkret për ju dhe për qytetarët që po na dëgjojnë: si shpjegohet që një pronar, i cili e ka marrë dokumentacionin pranë institucionit në vitin 1995-1996, nuk është trajtuar ende financiarisht, ndërkohë që një tjetër, i cili ka aplikuar në vitin 2013-2014, është trajtuar? Nëse nuk e keni të qartë, mund t’jua saktësoj edhe një herë.

**Jonida Baci** – Jam shumë e qartë.

Mënyra e rendit kronologjik bëhet fjalë jo për ditën e aplikimit, por për numrin se kur është dhënë vendimi. Nëse ky vendim është dhënë në vitin 1993, ai është kompensuar i pari dhe nuk ka mundësi që në 512 vendime të jetë kompensuar një vendim i vitit 2013. Unë po flas për kohën e dhënies së vendimit dhe ky quhet rend kronologjik. Patjetër që...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Ulsi Manja** – Faleminderit , zonja Baci!

Më falni, zoti Leka , por e ka kërkuar fjalën zonja Hysi dhe më pas mund ta merrni ju.

Zonja Hysi, keni fjalën për pyetje.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Baci, për raportimin!

Unë po lexoja raportin e depozituar, ndërkohë që ju dëgjova me vëmendje. Unë kam disa pyetje lidhur me raportin, por edhe me ato çfarë ju thatë.

Në raport ju përmendët se ka pasur mbi 16 mijë kërkesa, nga të cilat janë përmbyllur 6 mijë dhe pjesa tjetër, rreth 6900 kërkesa, i janë dërguar gjykatës me argumentin, nëse ju kam kuptuar saktë, se afati kohor i vendosur nga ligji, 3 vjet, nuk ka qenë i mjaftueshëm. Gjithashtu, ju keni edhe një vendim në Gjykatën Kushtetuese dhe keni vetëm një vit kohë në dispozicion. Cila është arsyeja që nuk e keni kërkuar amendimin e kësaj periudhe, por i keni hedhur 6900 qytetarë në dyert e një drejtësie, që ende vazhdon të jetë e korruptuar dhe nuk adreson problemet e tyre?

Së dyti, ju në raport përmendni se gjatë vitit 2018 për vendimet tuaja janë depozituar 162 padi. Besoj se paditë janë bërë nga qytetarët për shkak se janë rrëzuar 18 dhe janë pranuar 7. Cili është objekti i padive në përgjithësi? Ju sugjeroj që t’i mbani shënim pyetjet, sepse kam disa. Këtu nuk thuhet se cili është objekti i padisë.

Së treti, më ka shqetësuar çështja e kallëzimeve penale, madje këtë shqetësim e kam ngritur edhe kur institucionin e ka drejtuar zonja Qato, nisur edhe nga shumë vendime të prokurorisë që na kanë sjellë qytetarët, ku rezulton se ka falsifikime. Prokuroria ka vendosur

pushimin e këtyre hetimeve për shkak se nuk gjendet autori që ka bërë falsifikimin, por pronat e përvetësuara nëpërmjet vendimeve dhe të regjistruara në ATP nuk bëjnë fjalë për 1 apo 2 metra katrorë, por janë me mijëra.

Në raportin që ju keni paraqitur përsëri më rezulton se shumica e këtyre vendimeve janë pushime dhe mos fillime, për të cilat nuk e di arsyen. Këto janë pushime, sepse paditë që keni bërë nuk janë të shkruara saktë dhe nuk ka prova? Më bën shumë përshtypje aty ku thuhet: “Për 30 vendime ka kaluar afati”, pra ankimimi është bërë me vonesë dhe si është menduar të zgjidhet? Pra, këta qytetarë që kanë vjedhur pronat dhe që rezulton që i kanë me firma të falsifikuara, do të vazhdojnë t’i zotërojnë këto mijëra hektarë tokë?

Pyetja tjetër lidhet me bllokimet që keni bërë, është shumë interesant informacioni që jepni, ku thoni se keni bllokuar dhe evidentuar një fond prej 23 400 pasurish, gjithashtu, keni verifikuar 13055 pasuri, të cilat rezultojnë me probleme vetëm në katër qarqe, si Korçë, Berat, Gjirokastër dhe Elbasan. Cila do të jetë zgjidhja e trajtimit të këtyre pronave që kanë probleme?

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Hysi!

Zonja Baci, ju lutem, përgjigjet të jenë të shkurtra, por, nëse dëshironi përgjigje të caktuara, mund t’ua kaloni kolegëve tuaj.

**Jonida Baci** – Për sa i përket pyetjes se përse nuk kërkuam zgjatje të afatit të ligjit, siç jeni në dijeni ligji nr. 133 ishte nën monitorim nga komiteti i ministrave dhe çdo zgjatje do të penalizonte vlerësimin e ligjit. Meqenëse ky ishte një proces dhe fakti ishte i paracaktuar në nenin 34 për çdo nga mundësitë e mbetura u pa e arsyeshme të mos vijohej me zgjatjen e afatit. Kjo është arsyeja kryesore.

Nga një analizë e bërë, e cila duhet të thellohej, u pa që u prekën vendimet më të vjetra nga ana kronologjike dhe jo të reja. 6 mijë dosjet, që erdhën me ligjin nr. 133, ishin me nga një fletë, çoftë edhe me një certifikatë, për të kapur afatin, pra të paplotësuara kurrë. Ne u munduam të merreshim me dosjet e ardhura në ish-komisionet dhe në ATP, që nga viti 1993 e tutje, për t’i trajtuar sa më shumë. Pra kjo është arsyeja kryesore për mos zgjatjen e afatit të ligjit.

Pyetja tjetër për 6950 rastet e lëna, nga këto vetëm 6 raste janë ankimuar. Ne mund të sjellim një informacion të detajuar me objekt padinë, sepse kemi dhënë vetëm një total të rasteve për sa i përket vlerësimit, procesit të kompensimit, vlerësimit dhe procesit të trajtimit të kërkesave të reja.

Në lidhje me pushimin e hetimit nga prokuroria, ne i kemi ndjekur procedurat sipas ligjit. Kjo mbase nuk është detyrë e ATP-së, por duhet bërë një diskutim edhe më i gjerë brenda task forcës, por edhe me ju për vijueshmërinë.

Unë mbaj mend që kemi komunikuar bashkë në telefon se çfarë ndodh me faktin që parashkruhet dhe me qytetarin. Në fakt, për hir të së vërtetës, edhe për arsyen e mbingarkesës së këtij viti, ne thjesht bëmë evidentimin. Për këtë ne mund të bëjmë një diskutim të gjerë me një grup pune, me ministritë dhe bashkë me ju për të ditur....

*(Ndërhyje pa mikrofon)*

Ne kemi aktmarrëveshje në fuqi që është bërë nga drejtoresha e mëparshme, por nuk ka pasur një riaktivizim të kësaj çështjeje, por thjesht një detyrë e lënë dhe e evidentuar.

Për një nga pikat që shtroi zonja Hysi, unë nuk e di nëse Avokatura ka bërë padi civile...

**Ulsi Manja** – Ju lutem përmbledhni përgjigjet tuaja, ndërsa Avokatura të mbajë shënim përgjigjet që i përkasin asaj. Avokatura do të raportojë në Komisionin e Ligjeve në lidhje me vendimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me çështjet e pronësisë.

Mund të vazhdoni.

**Jonida Baci** – Për çështjen e bllokimit të pasurive, pra bëhet fjalë për fondin në dispozicion të ATP-së, pra ideja është se cilat janë 350 rastet problematike kur ka mbivendosje. Vërtet ATP-së i është dhënë ky fond ndër vite, por kurrë nuk ishte regjistruar apo bllokuar. Në momentin e bllokimit ne kuptuam që këtu ka mbivendosje. Procedura që do të ndiqet është kjo: ne nuk i nxjerrim nga fondi ynë nëse Ministria e Bujqësisë, e cila ka siguruar fondin, nuk bën zëvendësimin. Kjo për të siguruar që ne të mos ngelim pa gjë.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Baci!

Fjalën e ka kërkuar kolegu Leka.

**Edmond Leka** – Faleminderit, kryetar!

Unë kisha një pyetje për njohjen dhe kompensimin e pronës, veçanërisht për qarkun e Vlorës, i cili është shumë problematik. Nga takimet që kemi bërë me qytetarët dhe bisedat me ta, kemi evidentuar një problem shumë të madh që ka të bëjë me kompensimin. Dihet që 20% e kompensimit është në vlerë monetare dhe pjesa tjetër kryhet në natyrë. A ju duket e drejtë që kompensimi në natyrë të kryhet në qarqe shumë larg Vlorës, për shembull toka është në bregdet dhe kompensimi kryhet në Librazhd, në Elbasan dhe në Libohovë kanë marrë kompensim. Por

edhe në rastet kur pronarët pranojnë të marrin tokën, kur shkojnë atje toka është e zënë dhe fshati i përzë, sepse toka ka probleme të mëdha. Pra a ju duket e drejtë që ky kompensim të kryhet kaq larg, ndërkohë që toka është në bregdet, ku vlera është e pakompensueshme? Ky vendim mua më duket se nuk ekzekutohet kurrë.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Leka!

Po, zonja Baci.

**Jonida Baci** – Unë kam ardhur të flas si drejtoresha e ATP-së, nëse më duket apo jo e drejtë si individ kjo është diçka tjetër, por në kuadrin ligjor në fuqi dhe në mundësinë që i është dhënë sot ATP-së, fondi fizik tokë në dispozicion është në katër qarqet. Pas evidentimit të pronave shtetërore edhe nga agjencia e re e kadastrës është parashikuar që ky fond të pasurohet dhe në muajt në vijim ne do ta bëjmë këtë gjë. Por sot mundësia e kompensimit kryhet vetëm në katër qarqe dhe jemi munduar të mos krijojmë mbivendosje dhe problematika.

Ka raste të përsëritura ku për çështje si: tokë e zënë apo AMT-ët të dhëna, sepse ky është një proces, i cili është në vijimësi, pra ata regjistrojnë që toka është e lirë, por atje toka është e zënë, për këto ne kemi grupe të specializuara që shkojnë mbi 3-4 herë në terren përpara se të vendosin. Për 512 rastet e kompensuara nuk ka pasur problematika Kjo është një problematikë që vjen nga subjektet përpara se të vijnë të aplikojnë. Këtë do ta kemi parasysh edhe në vazhdim.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka. A ka diskutime? Nuk ka.

Avokatura e Shteti, a dëshiron të shtojë diçka në lidhje me procesin?

Po, zoti Metani.

**Artur Metani** – Përshëndetje, zoti kryetar!

Siç e thatë edhe ju ne do të kemi seancën tonë raportuese, sipas ligjit, por për efekt të këtij diskutimi, së pari, doja të eidentoja faktin e bashkëpunimit shumë të mirë midis Avokaturës së Shtetit, Ministrisë së Drejtësisë dhe Agjencisë së Trajtimit të Pronave që nga momenti i hartimit të ligjit, mbrojtjen në Gjykatën Kushtetuese, mbrojtjen në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe raportimet periodike që kemi para Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për ligjin nr. 133/2015.



Jemi munduar t'i përgjigjemi në kohë çdo shqetësimi dhe problematike që vjen nga zbatimi i ligjit nr. 133/2015, kemi botuar edhe një komentari, që e kemi nisur, por nuk e di nëse ka ardhur në Komisionin e Ligjeve, për njohjen dhe zbatimin më të mirë të këtij ligji.

Për sa u përket çështjeve që ngriti edhe deputetja Hysi, sipas të dhënave, për vendimet e pushimit të prokurorisë për vitin 2018 kemi tri çështje në Shkodër, 12 në Vlorë dhe 2 në Gjirokastrë. Në total janë 17 çështje, për të cilat Avokatura e Shtetit ka ngritur padi. Nga këto 17 çështje, 3-4 janë të fituara, por nuk është e nevojshme t'i themi këtu. Ky është numri i çështjeve për vitin 2018 dhe për të gjitha këto është ngritur padi, çdo vendim është ankimuar nga Avokatura e Shtetit, nuk ka vendim të paankimuar dhe çdo çështje është e përfaqësuar në gjykatë, nuk ka çështje të papërfaqësuar për pronat.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Metani!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Ulsi Manja** – Zoti Shameti, ju lutem!

**Artur Metani** – Edhe kemi fituar.

**Ulsi Manja** – Para se të mbarojmë me pikën e parë të rendit të ditës, natyrisht, dua ta falënderoj Agjencinë e Trajtimit të Pronave për punën e bërë për vitin 2018, për bashkëpunimin institucional që sapo e theksoi zoti Metani me Ministrinë e Drejtësisë apo Avokaturën e Shtetit, por edhe me qytetarët që kanë hallet dhe shqetësimet e tyre për pronat!

Dua të risjell në vëmendjen e kolegëve shqetësimin që ngriti kolegja ime, zonja Hysi, për çështjet e adresuara në prokurori. Janë rreth 17 çështje penale, pasi është arritur në konkluzionin që ka falsifikim, por është pushuar hetimi për shkak të afateve të parashkrimit të veprës penale. Ky mund të jetë një rast. Raste të tjera janë që hetimi ka arritur në përfundimin që ka falsifikim, por nuk gjendet autori dhe sërish, në kundërshtim flagrant me ligjin, prona vazhdon të mbahet e uzurpuar.

Ne, Agjencia e Trajtimit të Pronave, Avokatura e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme dhe Ministria e Drejtësisë kemi detyrim dhe përgjegjësi t'i japim zgjidhje kësaj çështjeje. Nëse është çështje që duhet të adresojmë ligjërisht, komisioni, Kuvendi i Shqipërisë, ka tagrin dhe pushtetin të ndërhyjë ligjërisht, por ju duhet të bëni sugjerimet konkrete përkatëse në cilat ligje duhet të ndërhyjmë si ligjvënës.

Nëse është çështje burokracie, që ligji ngarkon një institucion të caktuar për t'i dhënë zgjidhje këtij problemi dhe nuk e ka adresuar siç duhet, sërish duhet të ndërhyjë Kuvendi, sepse

është i patolerueshëm fakti që hektarë të tëra me prona, të marra nëpërmjet falsifikimit, të jenë të pushtuara nga qytetarë, që duhet të ishin në një vend tjetër, duhet të përgjigjeshin penalisht për uzurpimin e tokës. Deri tani janë 17 vendime që Avokati i Shtetit thotë: “Kemi bërë edhe padi civile”. Edhe në rast se gjykata do të disponojë kthimin e këtyre sipërfaqeve ndaj shtetit apo pronarëve të ligjshëm, unë jam shumë skeptik nëse do të vendoset e drejta e shkelur dhe prona t’i kalojë shtetit apo pronarit, por e shikoj të udhës të ndërhyhet me masa ligjore të tjera në ligj.

Ju falënderoj si Agjenci për punën dhe përkushtimin!

Komisioni i Ligjeve do të nxjerrë një raport pas kësaj seance dëgjimore, i cili do t’i njoftohet Kryetarit të Kuvendit dhe, sipas Rregullores, edhe seancës plenare. Në raport do të jenë të detajuara gjetjet e punës 1-vjeçare të Agjencisë suaj, por edhe detyrat që ne do të lëmë për Agjencinë tuaj për vitin pasardhës.

Ju falënderoj për prezencën në komisionin e sotëm!

Jeni të lirë dhe ditë të mbarë!



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 06.05.2019, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në strukturën dhe në organikën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. *(Komision përgjegjës)*.

**Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Korab Lita, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Elena Xhina, Edlira Bode dhe Xhemal Qefalia

**Mungojnë:**

Damian Gjiknuri, Alket Hyseni, Alban Zeneli, Elda Hoti dhe Tom Doshi

**Ulsi Manja** - Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës, shqyrtimin e projektvendimit “Për një ndryshim në strukturën dhe në organikën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Jemi komision përgjegjës dhe relator është zoti Fino.

Zoti Fino, fjala për ju.

**Bashkim Fino** – Faleminderit, kryetar!

Këtë projektvendim e kemi diskutuar edhe para një jave dhe kemi lënë kohë për të bërë një unifikim të të gjitha institucioneve që miratojnë strukturën këtu dhe që me vendim qeverie mund të kenë ndryshim të tabelës së pagave.

Herën e kaluar kërkoja një informacion nga Shërbimi u Monitorimit, të cilin jam duke e trajtuar. Më rezulton që ka institucione që e kanë miratuar strukturën në parlament, por për shkak të vendimit të qeverisë, kanë bërë ndryshimet e pagave pa reflektuar ndryshime në strukturën tonë këtu.

Duke u nisur edhe nga projektvendimi që kemi përpara për një ndryshim në ligjin nr. 2 të Kuvendit, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, zoti kryetar, kur diskutojmë strukturat, duhet të jenë përfaqësues Komisioneri përkatës i Diskriminimit apo Shërbimit Civil, Ministria e Financave apo Departamenti i Administratës Publike. Komisioneri mungon për arsye objektive sot, është jashtë Shqipërisë dhe unë do të kërkoja ta shtyjme këtë projektvendim. Nuk ka asnjë problem, por duhet të unifikojmë edhe me institucionet e tjera dhe të na lihen dy ditë kohë që bashkë me Drejtorinë e Monitorimit ta unifikojmë plotësisht dhe të kalojmë dy vendime: një për mbrojtjen nga diskriminimi të strukturës dhe një për Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për të cilat do të kemi dy vendime përkatëse. Pas këtyre dy vendimeve shpresoj dhe mendoj se do të kemi një unifikim të mirëfilltë të institucioneve që janë në varësinë tonë dhe nuk do të kemi më probleme. Thjesht është çështje kohe 2-3 ditë, sa të jenë prezent edhe përfaqësuesit, që të kenë komunikim, sepse nuk është thjesht detyrimi ynë të votojmë nga kategoria III a në III b dhe të mos kemi impenjimin e institucioneve përkatëse, të cilat e kërkojnë, por nuk janë prezente, duke filluar nga Ministria e Financave, nga Komisioneri apo Departamenti i Administratës Publike.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

Edhe unë bashkohem me sugjerimin e kolegut Fino, që këtë çështje ta shtyjme për mbledhjen e radhës, që të sigurojmë pjesëmarrjen e Ministrisë së Financave dhe dy komisionerëve, që kanë kërkuar ndryshimin respektiv në ligjet e tyre.

Kolegë, jeni dakord ta shtyjme këtë?

E mbyllim mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme.

Mbledhja e radhës bashkëngjitur me rendin e ditës, do t'ju njoftohet nëpërmjet postës elektronike.

Faleminderit! Ditë dhe javë të mbarë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**